



BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Prill 2022

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Prill 2022

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në këtë edicion të këtij buletini pasqyrohen aktivitetet për muajin prill të vitit 2022)

Blerim Isufaj propozohet për emërim në pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në Takimin e 212-të ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për Rishqyrtim për procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit. Anëtarët e KPK-së nuk e miratuan me rekomandimet e aprovuara pjesërisht nga Komisioni dhe, rrjedhimisht, me mosmiratimin e të gjeturave të Komisionit për



Rishqyrtim, KPK-ja, në zbatim të Rregullores nr.06/2019 për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës, kaloi në procesin e votimit të kandidatit më të vlerësuar për ta propozuar për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, me ç'rast, pas votimit të fshehtë, rezultoi që Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj, mori në mënyrë unanime 11 vota të anëtarëve të KPK-së. Ky vendim i Këshillit Prokurorial për propozimin e Isufajt në këtë pozitë do t'i dërgohet për dekretim Presidentes së Kosovës dhe pas dekretimit do të marrë zyrtarisht detyrën e tij.

Reagim nga Këshilli Prokurorial i Kosovës

Në një reagim të KPK-së, më 8 prill 2022, thuhet: "Këshilli i Prokurorial i Kosovës, gjatë ditëve të fundit muajit prill, është atakuar në mënyrën më të ulët nga përfaqësuesit politikë, përfshirë edhe deputetët e Kuvendit të Kosovës, individë që kanë kaluar dhe janë duke kaluar nëpër procedura penale dhe nga grupet e interesit, ku, sipas tyre, Këshilli Prokurorial dhe bartësit e funksioneve prokuroriale janë "grup dhe kokë kriminale".

Kjo gjuhë tejkalon të gjitha limitet e një gjuhë institucionale dhe shpërfaqë në mënyrë të qartë tendencat e hapura për rrënimin e sistemit prokurorial.



KPK-ja nuk do të tolerojë që të cenohet integriteti dhe reputacioni i anëtarëve të Këshillit Prokurorial dhe i bartësve të funksioneve prokuroriale.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, si institucion i pavarur kushtetues, ua bënë të qartë të gjithëve, përfshirë edhe përfaqësuesve politikë, se nuk do t'u bindet interesave politike dhe atyre të grupeve të interesit, pavarësisht tendencave të tyre.

Shqyrtohet drafti i Udhëzuesit për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit

Komisionit për Çështje Normative shqyrtoi draftin e Udhëzuesit për transferimin dhe avancimin e prokurorëve të shtetit.



Me këtë rast, u tha se ky draftudhëzues është i rëndësishëm së veçantë, sepse më herët nuk ka pasur një udhëzues të tillë, i cili ka rregulluar procedurën në detaje dhe kjo do të shërbejë në të mirë të sistemit prokurorial.

Mbahet takimi i 213-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës në takimin e 213-të miratoi Raportin e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik për periudhën tetor-dhjetor 2021, Raportin vjetor të Komisionit mbikëqyrës për zbatimin e Planit Strategjik dhe Planit të veprimit për luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike për vitin 2021 dhe

Raportin e Komisionit për rekrutimin e prokurorëve të rinj të shtetit, së bashku me propozimin e Komisionit për caktimin e këtyre prokurorëve përkatës.



Në fund të këtij takimi, u aprovuan edhe tri marrëveshje vullnetare për shkeljet e supozuara disiplinore, për të cilat do të bëhen publike vendimet përkatëse siç parashihet me ligj dhe miratoi kërkesën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Ferizajt për transferimin e përhershëm të një prokurori nga Departamenti për të Mitur në Departamentin për Krime të Rënda dhe raportet e paneleve hetimore, njërin ndaj një prokurori të Prokurorisë Themelore të Prizrenit dhe tjetrin ndaj një prokurori të Prokurorisë Themelore të Pejës.

Kryesuesi Jetish Maloku dhe Ambasadori i OSBE-së Michael Davenport diskutojnë për thellimin e bashkëpunimit

Kryesuesi Këshillit Prokurorial të Kosovës priti në takim Ambasadorin e Misionit të OSBE-së, me ç'rast diskutuan për thellimin e bashkëpunimit mes KPK-së dhe OSBE-së, me qëllim avancimin e



kapaciteteve profesionale dhe administrative të sistemit prokurorial, ku është theksuar se OSBE-ja në Kosovë ka dhënë një kontribut të rëndësishëm përmes mbajtjes së trajnimeve specifike në

mbështetje të KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit, në hartimin e planeve strategjike, objektiveve, akteve dhe udhëzuesve praktikë të punës.

Të dy bashkëbiseduesit janë pajtuar për vazhdimin e bashkëpunimit përmes projekteve të ndryshme, me qëllim të ngritjes së efikasitetit, efektivitetit dhe transparencës së sistemit prokurorial.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, cakton U.D Kryeprokurorin e Shtetit

Këshilli Prokurorial i Kosovës në takimin e 214-të caktoi Ushtruesin e Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, pasi që Kryeprokurori aktual, Aleksandër Lumezi, ka përfunduar mandatin prej shtatë vjetësh.



Anëtarët e KPK-së, me dhjetë vota caktuan Besim Kelmendin për Ushtrues të Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit.

Aprovohet Raporti financiar për periudhën janar-mars 2022

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës ka mbajtur takimin e radhës u shqyrtua Raporti financiar për tremujorin e parë të këtij viti dhe u prezantua buxheti dhe shpenzimet e krijuara në tremujorin e parë të vitit, për secilën kategori ekonomike në secilin program buxhetor të Këshillit.

Gjithashtu u aprovua edhe Raporti financiar për tremujorin e parë të vitit 2022, kurse kërkesat e tjera janë aprovuar në parim dhe do të dërgohen për shqyrtim tek mekanizmat përkatës për të shqyrtuar bazën ligjore të tyre.



Kryesuesi i KPK-së priti në takim përfaqësueset e Forumit të Grave Gjyqtare dhe Prokurore të Kosovës

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës priti në takim Kryesuesen e Forumit të Gjyqtarëve dhe Prokurore të Kosovës dhe Zëvendëskryesuesen e këtij forumi.



Në takim u diskutua thellimi i bashkëpunimit mes KPK-së dhe Forumit të Grave Gjyqtare dhe Prokurore të Kosovës, në mënyrë që të fuqizohet edhe më tej prania në sistemin e drejtësisë e gjyqtareve dhe e prokuroreve, duke realizuar vizionin për promovimin e barazisë dhe respektit për të gjithë.

Anëtarët e Komisionit për Administrimin e Prokurorive dhe Grupit punues për mbikëqyrjen e veprave të korrupsionit dhe krimeve ekonomike vizituan Prokurorinë Themelore të Mitrovicës

Komisioni për Administrimin e Prokurorive dhe Grupi punues për mbikëqyrjen e veprave të korrupsionit dhe krimeve ekonomike kanë vizituar Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, me ç'rast janë pritur nga Kryeprokurori i kësaj prokurorie.

Qëllimi i vizitës së sotme ishte monitorimi i proceseve të punës në këtë prokurori dhe diskutimi i disa temave për ngritjen e efikasitetit në punë.

Në këtë kontekst, u diskutua për raportet e veprave penale të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, veçanërisht për regjistrat e lëndëve dhe harmonizimin e tyre, të cilët vijnë nga shkrimoret dhe prokurorët për periudhën vjetore janar-dhjetor 2021 dhe atë tremujore janar-mars 2022.



Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

SKPK-ja, gjatë prillit 2022, ka mbajtur një takim të përbashkët me institucionet e drejtësisë dhe përfaqësuesit e Zyrës së BE-së për planifikimet për IPA 2023.

Gjithashtu në bashkëpunim me përfaqësuesit e UNDP-së është bërë finalizimi i specifikacionit teknik për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e portalit të sistemit prokurorial të Kosovës, me ç'rast pritet nga UNDP-ja që pas kësaj faze të iniciohet procedura e tenderimit dhe përzgjedhjes së operatorit ekonomik.

Nga ana tjetër, ka vazhduar hartimi i Raportit analitik nëntëvjeçar (2013-2021) për veprat penale karakteristike të mekanizmit përcjellës ndërinstitucional.

Në bashkëpunim me ekspertin e Projektit EUKOJUST është përgatitur draftdokumenti i specifikacionit teknik për furnizim me pajisje të TI-së dhe instalimin e tyre në Qendrën e Rimëkëmbjes dhe në bashkëpunim me trajnerët e projektit TIK/SMIL ka filluar ritrajnimi i prokurorëve dhe stafit administrative në të gjitha prokuroritë themelore për përdorimin e SMIL-it.

Ndërkohë është mbajtur edhe një punëtori e organizuar nga MCC (Sfidat e Milleniumit) për implementimin e fazës së dytë të projektit, qëllimi i të cilit është ngritja e transparencës në raport me publikun dhe krijimi i mundësisë për qasje në raportet statistikore që janë të nevojshme për qytetarët dhe krijimi i mundësisë së trajnimit nga distanca për stafin e prokurorisë.

Aktivitetet e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë

NJSHP-ja ishte fokusuar në hartimin e Raportit të punës së Prokurorit të Shtetit për tremujorin e parë të vitit 2022, Raportit për numrin e lëndëve të pranuar, të zgjidhura, aktakuzat e ngritura dhe të konfirmuara dhe vendimet e gjykatave për rastet korrupsionit dhe krimet të organizuar me kërkesë të ZKPSH-së, Raportit për realizimin e Planit të punës së KPK-së në tremujorin e parë 2022, Raporti përputhshmërinë e shënimeve statistikore të raporteve nga Shkrimorja dhe prokurorët për Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, raporti infografik për publikim në uebportal për tremujorin e parë 2022.

Gjithashtu, nga fusha e të dhënave statistikore janë grumbulluar të dhëna për punën të 11 prokurorëve në procesin e vlerësimit të tyre dhe ka përgatitur raporte statistikore për punën e prokurorive themelore dhe Prokurorisë Speciale, për Trem I-rë të vitit 2022, sipas llojeve të raporteve, është përpiluar Raporti statistikor për punën e Prokurorisë së Apelit dhe Raporti statistikor për Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, si dhe raporte të posaçme statistikore për rastet që kanë të bëjnë me integritet evropiane, MIE-n dhe raporte të posaçme për koordinatorët nacionalë për luftimin e krimeve për grupet e caktuara të veprave penale.

Nga fusha e ngritjes së kapaciteteve, në kuadër të programit për trajnimeve të vazhdueshme janë realizuar trajnime për menaxhimin e stresit, bashkëpunimi juridik ndërkombëtar në çështjet penale, mundësinë dhe sfidat, trafikimin e qenieve njerëzore, liria e shprehjes dhe liria e mediave, zbatimin e të drejtave pronësore intelektuale dhe trajnime të tjera.